


Himarë

- [JORGO SOKRAT GORO](#)
 - [Premtime elektorale - Jorgo Goro, Himarë](#)
 - [Kandidatët për Këshillin Bashkiak](#)
- [DHIONISIOS ALFRED PETRO BELERI](#)
 - [Premtime elektorale](#)
 - [Lista e këshilltarëve bashkiak](#)

JORGO SOKRAT GORO

PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË

Premtime elektorale - Jorgo Goro, Himarë

Premtimi	Data	Linku	Screenshot / Video
?Rruga e vjeter e fshatit Pilur	27 Prill 2023	https://www.youtube.com/watch?v=kCmX0esSKZc	
?Ujesjellesi i ri ne Piqeras		https://shqiptarja.com/lajm/kandidati-i-psse-per-himaren-jorgo-goro-ne-pustec-plane-per-investime-ne-infrastrukture-dhe-ne-turizmem-gati-ujesjellesi-i-ri	
?Rruga e Bunecit		https://shqiptarja.com/lajm/kandidati-i-psse-per-himaren-jorgo-goro-ne-pustec-plane-per-investime-ne-infrastrukture-dhe-ne-turizmem-gati-ujesjellesi-i-ri	
?24 ore uje per qytetin e Himares (paralelisht edhe sistemimi i ujrave te ndotura)	26 Prill 2023	https://www.facebook.com/6plus1vloratelevizion/video/198052859672715	
? Terbaç Ujesjellesi, rruga e fshatit		<ol style="list-style-type: none"> https://www.facebook.com/watch/?v=785195243168882 https://www.facebook.com/watch/live/?ref=watch_permalink&v=198052859672715 	

<p>? Lumi i Vlorës Pike grumbullimi dhe perpunimi per produkte bujqesore. Gati në shtator.</p>	<p>26 Prill 2023</p>	<p>https://www.facebook.com/6plus1vloratelevizion/videos/198052859672715</p>	
<p>? Kudhës Furnizimi me energji elektrike pa patur kurre nderprerje fale linjes se re qe investuam. Ujesjellesi i ri nje projekt i mbeshtetur nga ana e Qeverise Gjermane. Rruga e re aksesimi me Rrugen e Lumit te Vlores.</p>	<p>28 Prill 2023</p>	<p>https://www.facebook.com/watch/?v=620360310132675</p>	

1. Ambulanca e Shën Vasilit



Jorgo Goro për Himarën

6d · 🌐



Ambulanca e Shen Vasilit është një tjetër dëshmi e vertetësisë e punëve të realizuara, në të gjithë territorin e [Bashkia Himarë](#).

E keni të gjallë pamjen e ambulancave kudo pranë Qendrave të Banuara të Bashkisë sone, objekte totalisht të rrenuara, pa shërbimin me minimal.

Kjo sepse opozita "non grata" nuk e ka patur qenien njëzore fare në fokusin e tyre. E gjithë vemendja e tyre ishte rrethimi i çdo gjeje me vlerë në Shen Vasil, pronat, gardhet, problemet, gjyqet, avokatet dhe sekseret.

Fat i madh që godina e rrenuar e kësaj ambulance nuk u tjetërsua, apo ndryshuar destinacioni i saj kryesisht në pika lojërë fati, ato që kjo opozitë i ka shumë përzier sidomos ajo me qenien njëzore.

Ashtu siç edhe ka dëshirë të bëjë në të ardhmen me Himarën kudo duke i trajtuar njëzërit dhe të ardhmen e tyre po kështu si kjo godinë.

Koherat kanë ndryshuar ndaj edhe i vëmë theksin saq shumë panorames krahesuese, se si ishte dikur çdo Qendër e Banuar në Bashkinë Himarë.

Jemi të fokusuar totalisht tek rruga jonë për të ecur vetëm përpara duke i lënë mjëranet të shpresojnë se do të vijne në krye të punëve në Himarën tonë me shpifje, trillime dhe shantazhe, madje edhe me shpikjen me të fundit në dhurimin e çelësit të Bashkisë Himarë.

Po kujt t'ja dhurojmë dhe çfarë projekti zhvillimi kanë për Himarën, kur sot janë të vdekur klinikisht nga SHBA dhe BE! Kur edhe mezete dhe rakite i ngatërrojnë me të bërit politik me fotoshop dhe të vjetra në kohë.

U ka ngele ora dhe ndaj edhe sot janë të perburur nga himarjotet duke i refuzuar publikisht. Ashtu siç edhe po u mbyll derën Athina pasi i pa se kush ishin dhe sa tinezisht i perdoren marrëdhëniet tona me fqinjët tradicional.

[#VetëmPërpara](#) ➡ [#KurrëMëMbrapa](#) ←

Kandidatët për Këshillin Bashkiak

Qarku	Bashkia	Subjekti zgjedhor	Emri	Mbiemri	Kryetar/Këshill
Vlorë	Himarë	Partia Socialiste e Shqipërisë	Gjergji	Iliadhi	Keshill
Vlorë	Himarë	Partia Socialiste e Shqipërisë	Elisabeta	Lamaj	Keshill
Vlorë	Himarë	Partia Socialiste e Shqipërisë	Nikolin	Laska	Keshill
Vlorë	Himarë	Partia Socialiste e Shqipërisë	Mirka	Gjiçali	Keshill
Vlorë	Himarë	Partia Socialiste e Shqipërisë	Dhimitër	Kapaj	Keshill
Vlorë	Himarë	Partia Socialiste e Shqipërisë	Loreta	Isufi	Keshill
Vlorë	Himarë	Partia Socialiste e Shqipërisë	Thodhori	Foto	Keshill
Vlorë	Himarë	Partia Socialiste e Shqipërisë	Nertila	Husi	Keshill
Vlorë	Himarë	Partia Socialiste e Shqipërisë	Artionil	Shirokaj	Keshill
Vlorë	Himarë	Partia Socialiste e Shqipërisë	Eva	Petromilo	Keshill
Vlorë	Himarë	Partia Socialiste e Shqipërisë	Ferdinant	Lalaj	Keshill
Vlorë	Himarë	Partia Socialiste e Shqipërisë	Margarita	Gjini	Keshill
Vlorë	Himarë	Partia Socialiste e Shqipërisë	Albano	Shkurtaj	Keshill
Vlorë	Himarë	Partia Socialiste e Shqipërisë	Flora	Abedini	Keshill
Vlorë	Himarë	Partia Socialiste e Shqipërisë	Neritan	Hajdini	Keshill
Vlorë	Himarë	Partia Socialiste e Shqipërisë	Anila	Kongjini	Keshill

Vlorë	Himarë	Partia Socialiste e Shqipërisë	Dhimitër	Velço	Keshill
Vlorë	Himarë	Partia Socialiste e Shqipërisë	Stavrulla	Gjoni	Keshill
Vlorë	Himarë	Partia Socialiste e Shqipërisë	Thodhori	Beja	Keshill
Vlorë	Himarë	Partia Socialiste e Shqipërisë	Donika	Kolagji	Keshill
Vlorë	Himarë	Partia Socialiste e Shqipërisë	Miljano	Bitri	Keshill
Vlorë	Himarë	Partia Socialiste e Shqipërisë	Marsela	Strataj	Keshill

DHIONISIOS ALFRED PETRO BELERI

BASHKË FITOJMË

- “Partia e Lirisë” (PL);
- “Partia Demokristiane e Shqipërisë” (PDK);
- “Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut” (PBDNJ)

Premtime elektorale

- <https://www.beleris.com/al/>

Fredi Beleri Programi.pdf 2 / 3 84%

1. Zgjidhje për çështjen e Pronave – Garantimin e të drejtës së pronës dhe kthimin në efçente e të shfrytëzueshme të të gjitha pronave të bashkëqytetarëve tanë.

- ✓ Zbatimi i parimit që në bashkinë e Himarës ka tre pronarë: Pronat e Qytetarëve të Himarës, Pronat e Bashkisë Himarë (komunitare) dhe Pronat e Kishës.
- ✓ Ngritja e menjëhershme e një Zyre se Regjistrimit të Pronave në bashkinë e Himarës me qëllim vënien e saj në funksion dhe shërbim të bashkëqytetarëve tanë, për tu shërbyer atyre shpejt dhe në mënyrë transparente, duke dhënë njëkohësisht ndihmë dhe mbështetje për problemet e pronësive gjithë pronarëve të Himarës.
- ✓ Ngritja e menjëhershme me shpenzimet e bashkisë të Zyrës së Shërbimit të Bashkisë Himarë – Help Desk për konsultim dhe mbështetje ligjore falas për të gjithë qytetarët për zgjidhjen e çështjeve të tyre pronësore.
- ✓ Dhënia pa vonesa të lejeve të rrethimit të pronës për të gjithë ata që kanë dorëzuar dokumentet për regjistrim në regjistrin e pasurive të paluajtshme dhe që janë në pritje të lëshimit të certifikatave. Në këtë mënyrë do të kapërcejmë vonesat e qëllimshme apo të paqëllimshme që mendojnë bashkëqytetarët tanë dhe dhënia e garancive të shtuara për pronat.
- ✓ Dhënia e lejeve të ndërtimit për objektet nën 250 metra katrorë brenda 45 ditëve, siç e parashikon ligji, afat ky që sot nuk respektohet qëllimisht për arsye të njohura.

2. Riorganizimi i Bashkisë dhe Shërbimeve të saj duke u mbështetur në 3 parime bazë: Administrimi i mirë i Financave – Sigurimi i mbështetjes financiare për Bashkinë nga burime të ndryshme dhe – Transparenca në shërbimet e dhëna qytetarëve.

- ✓ Në këtë kontekst, zbatimi i parimit që në Bashkinë e Himarës Kryetari i Bashkisë është i pari mes të barabartëve dhe dera e Bashkisë dhe e Kryetarit të Bashkisë është e hapur për të gjithë qytetarët, kudo dhe ngado ata vijnë, pavarësisht nëse votojnë apo jo, do të jetë bosh themeltar në qeverisjen e nesërme të bashkisë.
- ✓ Riformatimi i Shërbimeve të ofruara prej Bashkisë, me shërbime dhe procedura digjitale, për shërbim të shpejtë dhe transparent ndaj bashkëqytetarëve, luftë kundër korrupsionit njeherë e përgjithmonë, me takime të hapura publike për qeverisje më të mirë dhe më transparente do të jetë një objektivi tjetër themeltar i yni.
- ✓ Menaxhimi i financave të bashkisë dhe logjistikës dhe Kryetarit për çdo shërbim dhe investim të kryer do të jetë rutina në qeverisjen e nesërme.
- ✓ Ngritja e Këshillit të Himarioteve ne Emigracion për tërheqjen dhe mobilizimin e të gjithë emigrantëve të Bashkisë sonë dhe veçanërisht intelektualëve, sipërmarrësve dhe profesionistëve të spikatur në mënyrë që nëpërmjet një rrjeti vullnetarësh të kontribuojnë me ide, propozime dhe plane në zhvillimin lokal dhe për të siguruar mjete financiare për zbatimin e tyre.
- ✓ Formimi i një grupi të veprimit – Task Force për hartimin dhe paraqitjen e propozimeve për financimin e zhvillimit të infrastrukturës publike me fonde të financuara nga Bashkimi Evropian, Banka Botërore etj, fonde këto që do të kapërcejnë dhe plotesojnë grantet e pamjaftueshme shtetërore me qëllim përmirësimin e jetës tonë të përditshme.

3. Politika të mbështetjes Sociale prej Bashkisë për të gjithë, me prioritet për bashkëqytetarët tanë të moshuar dhe fëmijët tanë që janë edhe e ardhmja e Himarës.

- ✓ Rikonstrukcioni dhe ndërtimi me prioritet i 6 këndeve të lojërave dhe 4 parqeve të vogla nëpër lagje, në pjesë të përzgjedhura të të gjithë fshatrave të Himarës, në mënyrë që në çdo lagje fëmijët tanë të kenë ambiente kreative për të luajtur të sigurt, ndërkohë që do të rikonstruktohen të gjitha ambientet sanitarë (tualetet), ambientet sportive dhe fushat sportive në të gjitha shkollat e bashkisë.
- ✓ Krijimi i Bibliotekës Digjitale Bashkake me akses falas për të gjithë studentët e Bashkisë si dhe salla kompjuterike – laboratorë për të rritur aftësitë e tyre dhe integrimin e tyre të sigurt në ekonominë dhe shoqërinë digjitale.

- ✓ Sigurimi i bursave dhe sigurimi i çdo ndihme të mundshme për të gjithë gjimnazistet ekselehtë, pavarësisht kombësisë, për të studiuar në Universitetet Greke përfshirë edhe ndihmën për tu strehuar në konvikte për çdo të ri të Himarës që do të studiojë në Universitetet Greke me qëllim uljen e kostove financiare për arsimimin e tyre.
- ✓ Hapja e Shkollës Profesionale për Turizmin me qëllim trajnimin dhe kualifikimin e të rinjve dhe të rriturve në funksion të krijimit dhe forcimit të burimeve njerëzore vendase në shërbim të turizmit si edhe për përmirësimin e ofertës turistike të zones tonë.
- ✓ Përforcimi i arsimit parashkollor me transport falas për fëmijet dhe programe mbështetëse për prindërit dhe çiftet e reja me synimin që të rinjtë tanë të jetojnë në vendin e tyre me të gjitha kushtet dhe mundësitë që meritojnë.
- ✓ Zbatimi i menjëhershëm i Mjekësisë Parandaluese dhe funksionimi i Njësisë Lëvizëse të Mjekësisë Parandaluese që do të arrijë në çdo lagje dhe shtëpi të bashkisë për të ofruar shërbime falas dhe të shpejta kryesisht për të moshuarit dhe njerëzit e vetmuar e të pa mundur.
- ✓ Riorganizimi i menjëhershëm i Transportit Publik në bashkëpunim me operatorë privatë për të mbuluar dhe garantuar transportin ndërmjet fshatrave të Bashkisë Himarë nëpërmjet financimit nga bashkia, në funksion të transportit të sigurt, të shpejtë dhe me çmim të ulët.
- ✓ Ndërtimi i një terminali autobusësh me qëllim menaxhimin e flotës sa më të mirë dhe shërbimit ndaj qytetarit.
- ✓ Rikonstrukcioni i menjëhershëm i të gjitha mureve rrethuese, shtimi i çezmave të ujit, ndërtimi i sheshpushimeve me stola dhe tenda në të gjitha varetat e fshatrave tona.

Krijimi i një linje direkte komunikimi dhe mbështetjeje për dhunën ngaj grave dhe dhunën në familje.

4. Përmirësimi i cilësisë së jetesës nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës dhe mbrojtjes së mjedisit.

- ✓ Kontrolli direkt dhe respektim rigoroz i të gjitha elementeve, specifikimeve ligjore dhe protokolleve sanitare lidhur me kontrollin dhe cilësinë e ujit të pijshëm si dhe rinovimin dhe mirembajtjen e rrjetit të ujësjellësit, në mënyrë që të sigurohet ujë i pijshëm 24 orë në ditë për të gjithë banorët e bashkisë Himarë.
- ✓ Krijimi i një programi të ri për menaxhimin dhe grumbullimin e mbetjeve dhe pastrimin e fshatrave tona, riorganizimin e pikave të grumbullimit të mbetjeve dhe sigurimin e një mjedisi të shëndetshëm për qytetarët dhe vizitorët. Ndërtimi i koshave, i kazanëve të grumbullit të mbetjeve, përcaktimi i hapësirave, shtimi i mjeteve grumbulluese dhe mbrojtja e mjedisit janë disa nga masat imediate që do të merren me çdo kusht.
- ✓ Përforcimi me të gjitha mjetet teknologjike dhe teknike të mbrojtjes nga zjarri të objekteve publike si dhe të rrjetit zjarrfikës në nivel lokal me qëllim dhe në funksion të mbrojtjes së qytetarëve, pronave dhe gjithashtu mjedisit tonë natyror.
- ✓ Me një program gjithëpërfshirës 8-vjeçar, ne i japim prioritet projekteve infrastrukturore, mbrojtjes nga përmytjet dhe menaxhimit të ujërave të zeza. Ne do të sigurojmë menjëherë mbrojtjen e pasurisë sonë natyrore, të biodiversitetit, të brigjeve tona, të plazheve tona, të ujit tonë, duke përmirësuar pajisjet teknologjike të bashkisë dhe mbi të gjitha duke respektuar legjislacionin; duke parandaluar cdo rezik të tërë në mënyrë natyrore është trashëgimia jonë me e madhe dhe trashëgimia e vërtetë që do t'ua lëmë fëmijëve tanë.
- ✓ Ndërtimi i rrugëve të reja për transportin e lehtë dhe të sigurt të njerëzve dhe mallrave për aksesimin e të gjithë plazhëve mbrenda territorit të bashkisë edhe rrugët ndërmjet fshatrave tona.
- ✓ Njëkohësisht ne do të nisim programin e menjëhershëm të rregullimit dhe mirëmbajtjes së trotuarëve dhe rrugëve ekzistuese me ekipe të ndërhyrjes së menjëhershme me qëllim uljen e kostove të mëvonshme të riparimeve dhe ndërhyrjeve në infrastrukturë.
- ✓ Shtimi i ndriçimit publik, duke ndricuar çdo cep të fshatrave tona, në çdo lagje, në mënyrë që ne dhe vizitorët tanë të ndjehen të sigurt dhe çdo pjesë e territorit të bashkisë të jetë e aksesueshme.

Garantimin e aksesit në çdo cep të Bashkisë, me plazhe të hapura për të gjithë, me plazhe të paster për të gjithë.

- ✓ Evidentimi i të gjitha monumenteve të kulturës me synim mbrojtjen e tyre nga njëra anë dhe rritjen e vizitueshmëris së tyre, duke kontribuar në produktin turistik të bashkisë si edhe duke siguruar përfitime financiare për sipërmarrjet vendase.
- ✓ Sigurimi i një programi financimi për rindërtimin e fasadave të shtëpive dhe ndërtesave publike në të gjitha fshatrat tona me qëllim përmirësimin e mjedisit urban dhe forcimin e produktit tonë turistik, zbutjen e pasojave të emigrimit dhe braktisjes së banesave duke i kthyer ato në të banueshme apo në funksion të turizmit familjar.

5. Zhvillimi Lokal & Investimet Strategjike përfshirëse, me mundësi për të gjithë qytetarët.

- ✓ Krijimi i Zyrës së Sipërmarrjes – Help Desk ku çdo individ, profesionist, sipërmarrës do të mund të ketë konsultim falas për zhvillimin e biznesit apo idesë së tij dhe akses të drejtpërdrejtë për të kërkuar mbështetjen e bashkisë për financimin e biznesit të tij.
- ✓ Ndjekja e politikës zero taksa dhe tarifa vendore për çdo biznes të ri të krijuar nga qytetare deri në moshën 25 vjeç dhe ulje e taksave dhe tarifave bashkiake për të gjitha bizneset.
- ✓ Krijimi përmes dialogut me komunitetin dhe biznesin i një liste të drejtash dhe detyrimesh për çdo investim strategjik duke siguruar mbivlerë për vendin dhe njerëzit e tij.
- ✓ Sigurimin e përfitimit nga investimet strategjike për pronaret dhe banorët vendas, në mënyrë që të shmangët shfrytëzimi i kote dhe pa përfitim i pronave dhe asetëve të banorëve të Himarës dhe të garantohet shfrytëzimi, venia në efikasitet dhe përfitimi i lartë ekonomik prej tyre, parim ky të cilit do të përmbahemi me vendosmëri që nga dita e parë.
- ✓ Zhvillimi i një turizmi detar cilësor, turizmit kulturor dhe natyror përmes evidentimit të të gjitha burimeve tona historike, monumenteve të natyrës dhe vendeve me bukuri natyrore të vecante si dhe shtigjeve ecëse turistike në zonën malore dhe gjysmë malore të Bashkisë Himare.
- ✓ Krijimi i një identiteti tregtar duke shfrytëzuar praktikën e mira për Bashkinë Himarë dhe duke e promovuar atë në të gjithë botën nëpërmjet zbatimit të një programi të integruar promovues të Bashkisë dhe bizneseve vendase nëpërmjet medias moderne dixhitale, me njësi informacioni si dhe me praninë në të gjitha ekspozitat dhe panairët kryesore turistike me qëllim rritjen e fluksit të turistëve dhe vizitorëve nga njëra anë dhe nga ana tjetër përmirësimin e vazhdueshëm të cilësorisë së shërbimeve tona.
- ✓ Forcimi i bizneseve të vogla familjare në sektorin agroushqimor, njësitë bujqësore dhe blegtorale, me synim modernizimin e tyre por edhe lidhjen e tyre të drejtpërdrejtë me bizneset turistike të zonës. Trajnime, financime, ndërhyrje ndihmese në këto biznese në mënyrë që hapat e vegjël por të nevojshëm të ndërmerren tani, duke siguruar vende pune të qëndrueshme në të ardhmen.
- ✓ Promovimi i lidhjes detare Himarë – Ishujt Diapontia me qëllim rritjen e fluksit të turistëve që vizitojnë Himarën dhe hapjen e destinacioneve të reja turistike për zonën.
- ✓ Krijimin dhe dhenien e aksesit në pika ankorimi sezonale të ndërtuara nga Bashkia në Plazhin e Borshit, Spilese, Dhermiut për mjetet detare të vizitorëve dhe turistëve që aksesojnë brigjet e Himarës nëpërmjet rrugëve detare.
- ✓ Nderhyrje të menjehershme në rehabilitimin e rrugëve të Kalasë së Himarës, ndricimi i plote i saj dhe riparimi i mureve ekzistues dhe infrastruktures në funksion të turizmit.
- ✓ Nderhyrja të menjehershme për rehabilitimin dhe ndricimin e Shpelles së Spilese duke e kthyer në një destinacion turistik të vecante.
- ✓ Ndertimi i rrugës së Manastirit të Athalit dhe sistemimi i territorit përreth sipas standarteve më të larta (ndricim, shkallë, vende ulje) me qëllim ruajtjen dhe promovimin e zonës dhe objektit të kultit sipas traditës më të mire.

HIMARË: RRUGA "2 DHJETORI"
Tëll.: 00355 692792490 – 00355 69 237 2303

AΘHNA: Γραφείο Ασκληπιού 26-28
Tëll.: 00 30 698 3307374 – 0030 6985639308

Facebook Profil: Fredis Beleris (Fredis Beleris)
Facebook page: Φρέντης Μπελέρης – Fredi Beleris
Instagram: fredis.beleris (Φρέντης Μπελέρης)

E-mail: belerihimare@gmail.com | www.beleris.com

**BASHKË
FITOJMË**



Lista e këshilltarëve bashkiak

Qarku	Bashkia	Subjekti zgjedhor	Emri	Mbiemri	Kryetar/Këshill
Vlorë	Himarë	Bashkë Fitojmë	Afrovita	Dhimojani	Keshill
Vlorë	Himarë	Bashkë Fitojmë	Timoleo	Gërdhuqi	Keshill
Vlorë	Himarë	Bashkë Fitojmë	Silva	Burbo	Keshill
Vlorë	Himarë	Bashkë Fitojmë	Miltiadh	Prifti	Keshill
Vlorë	Himarë	Bashkë Fitojmë	Lenica	Kocani	Keshill
Vlorë	Himarë	Bashkë Fitojmë	Fuat	Mati	Keshill
Vlorë	Himarë	Bashkë Fitojmë	Thëllëza	Kokaveshi	Keshill
Vlorë	Himarë	Bashkë Fitojmë	Ervis	Çaushaj	Keshill
Vlorë	Himarë	Bashkë Fitojmë	Vadika	Goro	Keshill
Vlorë	Himarë	Bashkë Fitojmë	Emanuel	Milo	Keshill
Vlorë	Himarë	Bashkë Fitojmë	Areti	Varfi	Keshill
Vlorë	Himarë	Bashkë Fitojmë	Spiro	Maraçi	Keshill
Vlorë	Himarë	Bashkë Fitojmë	Elisabeta	Papajani	Keshill
Vlorë	Himarë	Bashkë Fitojmë	Sokrat	Kushta	Keshill
Vlorë	Himarë	Bashkë Fitojmë	Maria	Bollano	Keshill
Vlorë	Himarë	Bashkë Fitojmë	Veli	Pasha	Keshill
Vlorë	Himarë	Bashkë Fitojmë	Elisabeta	Zoto	Keshill
Vlorë	Himarë	Bashkë Fitojmë	Nestur	Varfi	Keshill
Vlorë	Himarë	Bashkë Fitojmë	Manuela	Balla	Keshill
Vlorë	Himarë	Bashkë Fitojmë	Pano	Dhimaleksi	Keshill
Vlorë	Himarë	Bashkë Fitojmë	Gilberta	Prifti	Keshill
Vlorë	Himarë	Bashkë Fitojmë	Stelio	Bollano	Keshill